



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/16/24**

Nënkryetari i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mentor Bajraktari, duke shqyrtuar ankesën e ushtruar nga N.B ndaj gjyqtarës A.K.P, për të vendosur për çështje disiplinore, në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 24.07.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga N.B ndaj gjyqtarës A.K.P, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës N.B përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datë 26.06.2024 përmes adresës elektronike ka parashtruar ankesë për gjyqtaren A.K.P. Ankesa është përcjellë te Autoriteti Kompetent me datë 04.07.2024.

Parashtruesi i ankesës në ankesën disiplinore të paraqitur përmes adresës elektronike ka kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë të ndërmarrin masa ligjore ndaj gjyqtarës A.K.P, pasi që sipas tij kjo gjyqtare e ka mbajtur përreth 6 vite lëndën me nr. 2019:175145 ku i njëjti është palë e dëmtuar, duke e zvarritur qëllimshëm, deri sa ka ardhur koha e parashkrimit. Sipas tij, nuk është e saktë se nuk ka adresë i akuzuari, kur në fakt i njëjti ka adresë të saktë në Obiliq dhe Hade. Por, sipas tij gjyqtarja e çështjes ka pasur ndikim nga i njëjti për mos ta shqyrtuar këtë lëndë dhe për mos ta dënuar. Në fund ka deklaruar se nëse gjykatat veprojnë në këto mënyra, atëherë qytetarët nuk kanë nevojë të kërkojnë drejtësi nëpërmjet këtyre gjyqtarëve të pandërgjegjshëm.

Në lidhje me pretendimet e parashtruara në këtë ankesë, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se me këtë lëndë është ngarkuar me datë 30.09.2021 dhe deri me këtë datë kjo lëndë ka qenë te gjyqtarja L.K, ku nga shkresat e lëndës shihet se është tentuar 2 herë të mbahet shqyrtimit në këtë lëndë gjyqësore, por nuk është arritur të sigurohet prezenca e palëve në procedurë, për çka edhe ka ardhur deri te shtyrja e seancave gjyqësore.

Sipas gjyqtarës, me datë 30.09.2021 është ngarkuar me rreth 1336 lëndë, në mesin e të cilave edhe lënda në fjalë. Sipas saj, duke pas parasysh ngarkesën e madhe me lende në këtë departament në përgjithësi dhe numrin e madh të lëndëve të natyrës urgjente të cilat vijnë dhe duhet trajtuar me urgjencë, siç janë lendet me paraburgim, numri i madh i lëndëve të dhunës

në familje, lëndëve me natyrë korruptive dhe lëndë të tjera që sipas listës së KGJK-se duhet trajtuar me urgjencë, kjo lëndë nuk është arritur të caktohet deri me datë 13.03.2024. Mirëpo, sipas saj as në ditën e parapare nuk ka mund të procedohet meqenëse në atë kohë dhe gati për dy muaj me radhe ka pasur probleme shëndetësore dhe ka qenë në pushim mjekësor.

Tutje ka deklaruar se pa kthimit nga pushimi mjekësor ka vazhduar me trajtimin e lëndëve që kanë mbetur përgjysmë, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare ka vërejtur se në këtë çështje penale ka arritur parashkrimi absolut. Për këtë me datë 27.05.2025 ka marrë aktvendim me të cilin është hedhë aktakuza për shkak të parashkrimit.

Në fund ka deklaruar se nuk është e vërtetë ta ketë njohur apo të jetë ndikuar në kurrfarë mënyrë nga i pandehuri, ngase sipas saj të njëjtin nuk ka pas as rastin që ta shoh ndonjëherë, arsyet e cekura më lartë janë arsyet e vetme dhe të vërteta lidhur me situatën e këtij rasti, ndërsa çdo pretendim tjetër është i pa vërtetë dhe i pambështetur në fakte dhe argumente.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarës A.K.P.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Në lidhje me pretendimin e paraqitur nga ankuesi se gjyqtarja e çështjes që 6 vite e ka zvarritur qëllimshëm këtë lëndë nuk qëndron, pasi që nga shkresat e lëndës shihet se gjyqtarja A.K.P është ngarkuar me këtë lëndë me datë 30.09.2021, të cilën e ka trashëguar nga gjyqtarja paraprake, në mesin e 1333 lëndëve me të cilat e njëjta është e ngarkuar.

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve parashihet se shkelja e detyrave të gjyqtarit bëhet nëse veprimet e gjyqtarit që dërgojnë deri në shkelje të detyrave bëhen me dashje a po nga pakujdesia e rëndë, gjë e cila nuk është vërtetuar në rastin konkret.

Kjo sepse, në bazë të shkresave të lëndës, mund të shohim se në këtë lëndë nga gjyqtarja paraprake e ngarkuar me këtë lëndë janë caktuar dy seanca gjyqësore të parapara të mbahen me datë 26.07.2021 dhe 29.09.2021, por nuk është arritur të sigurohet prezenca e palëve.

Po ashtu, nga shkresat e lëndës shihet se gjyqtarja aktuale e çështjes ka caktuar seancën gjyqësore për datë 13.03.2024, me qëllim të trajtimit të të njëjtës. Por sipas fletë kthesës, përsëri është konstatuar se adresa e palës është e panjohur, edhe pse i njëjti është ftuar në adresën e dhënë nga ana e Prokurorisë në aktakuzën PP.II.nr.3077/18 të datës 27.08.2018.

Në këtë rast nuk është provuar me asnjë prove se veprimet e gjyqtarës janë bërë me dashje a po nga pakujdesia e rëndë e të njëjtës, pasi që vet fakti se gjyqtarja e çështjes ka caktuar seancën gjyqësore për datë 13.03.2024, nënkupton se e njëjta ka pasur për qëllim trajtimin e kësaj lënde dhe përfundimin e të njëjtës para arritjes së afatit të parashkrimit, por për shkak të rrethanave shëndetësore të cilat janë të njohura për Autoritetin Kompetent, gjyqtarja A.K.P nga data 27.02.2024 ka qenë në pushim mjekësor në kohëzgjatje përreth 2(dy) muaj.

Po ashtu, mos caktimi i seancave gjyqësore për trajtimin e kësaj lënde ka ndodhur edhe për shkak të faktorit objektiv, numrit të madh të lëndëve me të cilin ballafaqohen gjyqtarët gjatë punës së tyre, pastaj numrit të madh të lëndëve të cilat kanë qenë në procedurë dhe janë transferuar te gjyqtarët tjerë pasi që kjo gjykatë viteve të fundit është duke u ballafaquar me lëvizje të mëdha të gjyqtarëve për shkak të avancimeve në gjykata më të larta dhe lëvizje të lëndëve nga një gjyqtar tek tjetri dhe në vazhdimësi janë duke u plotësuar pozitat e lira të gjyqtarëve.

Ndërsa, pretendimi se e njëjta qëllimshëm nuk e ka trajtuar lëndën pasi që është ndikuar në çfarëdo forme nga i pandehuri, nuk është provuar nga parashtruesi i ankesës, i cili ka barrën e të provuarit për pretendimet e paraqitura.

Autoriteti Kompetent duke parë ngarkesën e gjyqtarës me lëndë dhe pas vlerësimit të regjistrave të punës së gjyqtarës, ka gjet se deri te zvarritja e procedimit të kësaj lënde nga gjyqtarja ka ardhur si pasojë e ngarkesës me lëndë e jo për shkak se gjyqtarja me veprimet apo mosveprimet e saj ka ndikuar në zvarritje a po në parashkrim të lëndës.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/16/24, me datë 24.07.2024

Mentor Bajraktari

---

Nënkryetar i Gjykatës Themelore në Prishtinë